



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. prot _____

Tiranë __/__/2018

N J O F T I M

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të shqyrtuar p/vendimet e paraqitura nga Bashkia e Tiranës, ditën e enjte, datë **27.09.2018**, ora **11:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak, me këtë rend dite:

1. P/Vendim “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën **1-30.9.2018**”.
2. P/Vendim “Për miratimin e pagesës për PAK dhe Invalidët e Punës, për periudhën **1- 30 Shtator 2018**”.
3. P/Vendim “Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese, për periudhën **1- 31 Gusht 2018**”.
4. P/Vendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok- ndihmës ekonomike deri në **6%**, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën **1- 31 Gusht 2018**”.
5. P/Vendim “Për miratimin e sistemimit të fëmijës, Azvaldo Çeça, në institucionet e përkujdesjes shoqërore”.
6. P/Vendim “Për miratimin e projektit “Të rinj dhe të reja drejt një profesioni”, hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”.
7. P/Vendim “Për zbatimin e projektit “Programi i Nxitjes së Punësimit të Biznesit Rinor”, hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për zbatimin e këtij projekti”.
8. P/Vendim “Për miratimin e draft- kontratës së qirasë dhe akt marrëveshjes tip që do të lidhet midis Bashkisë Tiranë dhe debitorëve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës ish fonderia Mekanike”.

9. P/Vendim “Për përcaktimin e vlerës maksimale e minimale të qirasë sipas strukturave të apartamenteve dhe të vlerës maksimale e minimale të të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira, në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social, në zonën e Shkozës, ish Fonderia Mekanike””.
10. P/Vendim “Për miratimin e dhënies së ambientit në përdorim të Organizatës Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve- ARSIS, me destinacion për Qendër Sociale, në zbatim të projektit “Ngritja e Shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë”, nëpërmjet vënies në punë të qendrës multidisiplinare në Njësinë Administrative Nr.7”.
11. P/Vendim “Mbi miratimin e krijimit të Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi””.
12. P/Vendim “Për krijimin e Qendrës Sociale “Streha Tiranë””.
13. P/Vendim “Për miratimin e strategjisë së artit dhe kulturës për Bashkinë Tiranë 2019- 2024”.
14. P/Vendim “Për miratimin në parim të studimit të fizibilitetit dhe të kontratës të partneritetit publik privat “Për hartimin, ndërtimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e terminalit të transportit publik në Tiranë, ndërmjet Bashkisë Tiranë në rolin e autoritetit koncensionar dhe bashkimi i shoqërive “Salillari SHPK & Hellas Servis SHPK & Analysis Computers& Software S.A & Klodioda SHPK”, me cilësinë e koncensionarit”.
15. P/ Vendim “Për miratimin në parim të dhënies me qira të objektit “Reparti i Orëve”, pasuri në administrim të ndërmarrjes Metalike Tirana, dhe të truallit me sipërfaqe 10458.81 m2, në rrugën “Hamdi Pepa”, prona në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
16. P/Vendim “Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018- 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018 (i ndryshuar)””.
17. P/Vendim “Për mbështetje financiare nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë të Tiranës”.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Figurave të shquara të qytetit:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 13 dhe do të mbledhet ditën e martë, datë **25.09.2018, ora 11:00.**
- **Komisioni i Strehimit dhe Çështjeve Sociale:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 5, 8, 9, 10, 11, 12 dhe do të mbledhet ditën e martë, datë **25.09.2018, ora 12:00.**
- **Komisioni për Politikat Rinore:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 6, 7, 16 dhe do të mbledhet ditën e mërkurë, datë **26.09.2018, ora 11:00.**
- **Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 14, 15, 16 dhe do të mbledhet ditën e mërkurë, datë **26.09.2018, ora 12:00.**
- **Komisioni Juridik:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 15, 16 dhe do të mbledhet ditën e mërkurë, datë **26.09.2018, ora 13:30.**

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI